



| | | | |
|--|--------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar Punëpoq/Prodato Received/Delivery | 14.12.2022 | 2 | viti god year |
| Organ /Njësia Org /Jedinitca Org /Unit | Nr Prot Bil Prot Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKPMSTK | 8054/2022 | | 116 |



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.788/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga ; Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtare ,si dhe -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit A.nr.2790/21 i datës 10.11.2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.788/2021 të datës 08.09.2021 të parashtruar

, të cilët me autorizim i përfaqëson , kundër organit të punësimit/Secretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 dhe 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 14.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Hedhet poshtë si e pa lejuar ankesa me numër A.nr.788/2021 e datës 08.09.2022 e parashtruar nga ankuesit,

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.788/2021 e datës 08.09.2021 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesit: [redacted] sipas Akt Emërimit të datës 28.12.2012 është e punësuar në pozitën Sekretare Juridike në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Dega Lipjan, [redacted] sipas Akt Emërimit të datës 28.12.2012 e punësuar në pozitën Sekretare Juridike në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Dega Lipjan, [redacted] e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 28.12.2012 në pozitën Sekretare Juridike në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Dega Lipjan, [redacted] e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 28.12.2012 në pozitën Arkatare në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Dega Lipjan, [redacted] e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 25.07.2017 ne pozitën Zyrtare Ligjore në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Dega Lipjan, [redacted] e punësuar sipas Akt Emërimit te datës 25.07.2017 në pozitë Zyrtare Ligjore në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Dega Lipjan, [redacted] e punësuar sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit të datës 25.01.2021 në pozitën Referent në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Dega Lipjan, [redacted] e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 28.12.2012 në pozitën Sekretare Juridike në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Dega Lipjan, [redacted] e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 28.12.2012 në pozitën Asistente e Gjyqtarit Mbikëqyrës në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Dega Lipjan, [redacted] punësuar sipas Akt Emërimit të datës 28.12.2012 në pozitën Arkatare në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Dega Lipjan, [redacted] e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 28.12.2012 në pozitën Përkthyesë Shqipe-Serbisht dhe Anasjelltas në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Dega Lipjan, [redacted] e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 28.12.2012 në pozitën Sekretare Juridike në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Dega Lipjan dhe Enver Ramadani i punësuar sipas Kontratës se punës për kohë të pacaktuar të datës 15.06.2017 në pozitën Vozitës në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Dega Lipjan.

Me datë 15.07.2021 ankuesit kanë parashtruar kërkesë për kompensimin e shpërblimit jubilar dhe për dalje në pension në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, ndërsa përmes përgjigjes në kërkesë të datës 05.08.2021, Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Departamenti të Administratës së Përgjithshme në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës duke i njoftuar se nuk mund të bëhet kompensimi për 20 vite të shpërblimit jubilar për faktin se shërbimi civil ka filluar të aplikohet sipas Rregullores së UNMIK-ut 2001/36.

Ankuesit me datë 08.09.2021 kanë parashtruar ankesë me Nr. Prot: 4540/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensimin e pagës jubilarë për 20 vite në shërbimin civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në mungesë të kuorumit për vendosje më datë 15.10.2021 ka njoftuar përfaqësuesin e ankuesve lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës dhe ka udhëzuar të njëjtin që t'i ndjek procedurat e mëtejme në pajtim me Ligjin për Konfliktet Administrative. Ankuesi ka ndjekur procedurat gjyqësore duke

hapur konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, më datë 10.11.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2790/2021 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve duke e anuluar njoftimin e Këshillit të datës 15.10.2021 dhe duke e detyruar Këshillin që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 08.09.2021 të ankuesve.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesve të datës 08.09.2021 me numër protokoll 4540/2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigje në kërkesën e datës 05.08.2021 nga Ud.Drejtorit të DAP në SKGJK; Autorizimi i datës 10.09.2021; Autorizimi i datës 10.09.2021; Autorizimi i datës 16.07.2021; Autorizimi i datës 07.07.2021; Autorizimi i datës 16.07.2021; Autorizimi i datës 23.06.2021; Autorizimi i datës 07.07.2021; Autorizimi i datës 07.07.2021; Autorizimi i datës 07.07.2021; Autorizimi i datës 23.06.2021; Autorizimi i datës 15.07.2021; Autorizimi i datës 07.07.2021; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 24.09.2021 me numër protokoll 4771/2021; Përgjigje në ankesë e datës 21.10.2021 me numër protokoll 5112/2021 bashkë me shkresat e lëndës; Dëshmia për pagesën e pagës për pensionim për [redacted] e datës 01.06.2021; Dëshmia për pagesën e pagës për pensionim për [redacted] e datës 01.07.2021; Kërkesë e datës 15.07.2021 për kompensimin e shpërblimit jubilar dhe për dalje në pension; Kërkesë e datës 01.10.2021 për shpërblimin e përvjetorit jubilar; Kërkesë e datës 30.09.2021 për shpërblimin e përvjetorit jubilar; Kërkesë e datës 01.10.2021 për shpërblimin e përvjetorit jubilar; Kërkesë e datës 01.10.2021 për shpërblimin e përvjetorit jubilar; Pagesa në muajin dhjetor 2013 për [redacted] Vendimi i datës 08.04.2022 me nr.460/2022 për përvjetorin e shpërblimit jubilar; Pagesa e muajit dhjetor 2013 për pagën jubilarë; Pagesa e muajit dhjetor 2013 për pagën jubilarë; Pagesa e muajit dhjetor 2013 për pagën jubilarë; Vendimi i datës 27.05.2021 me nr.ref.DS-274/2021 për përfundimin e marrëdhënies së punës për [redacted]; Vendimi i datës 26.04.2021 me nr.ref.DS-214/2021 për përfundimin e marrëdhënies së punës për [redacted] Pagesa e muajit dhjetor 2021 për pagën jubilarë; Akt emërimi i datës 28.12.2012 me nr.03/112-1007; Akt emërimi i datës 28.12.2012 me nr.ref.03/112-1030; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i datës 25.01.2021 me nr.ref.DS-049/2021; Akt emërimi i datës 24.07.2017; Kontratë pune për kohë të pacaktuar e datës 15.06.2017; Akt emërimi i datës 28.12.2012 me nr.ref.03/112-1024; Akt emërimi i datës 28.12.2019 me nr.03/112-1019; Akt emërimi i datës 28.12.2012 me nr.ref.03/112-1013; Akt emërimi i datës 24.07.2017; Akt emërimi i datës 28.12.2012 me nr.ref.03/112-1027; Akt emërimi i datës 28.12.2012 me nr.ref.03/112-102; Njoftimin e datës 15.10.2021; Aktgjykimin A.nr.2790/21 i datës 10.11.2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesve si në pikën I të dispozitivit, është e pa lejuar, sepse:

Ankuesit ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e kanë parashtruar kundër përgjigjes në kërkesë të datës 05.08.2021 të Ushtruesit të Detyrës së Drejtorit të Departamenti të Administratës së Përgjithshme në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankuesve, Kolegji i Këshillit, i'u referuar Aktgjykimit në rastin Nr.KO203/19 me numër reference AGJ 1583/20 të datës 09.07.2020 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se: *Ligji nr.06/L-114 për Zyrtaret Publike nuk zbatohet ne raport me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, përderisa cenohet pavarësia funksionale dhe organizative e garantuar me Kushtetute.* Po ashtu, me të njëjtin aktgjykim është shfuqizuar neni 85 i Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, e që nënkupton se Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës është i zbatueshëm për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, kështu që nëpunësit civil e Sekretarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, lidhur me cenimin e të drejtave nga marrëdhënia e tyre e punës duhet të parashtrojnë ankesë konform Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës, konkretisht me nenin 81 është përcaktuar se: *1.Organe të veçanta për zgjidhjen e kontesteve të punësimit dhe të ankesave në shërbimin civil do të themelohen në kuadër të secilit institucion të administratës qendrore dhe komunale, që ka nëpunës civilë. 2. Procedurat për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave zhvillohen nga këto organe: 2.1. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; dhe 2.2. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, ndërlidhur me këtë, nenin 4 paragrafi 1 i Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave ka specifikuar se: nëpunësit civilë kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo çdo shkelje apo lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe kanë të bëjnë me marrëdhënien e tyre të punës”, e mbi këtë bazë ligjore rrjedhë se ankuesit në rast të pakënaqësisë ndaj përgjigjes në kërkesë të datës 05.08.2021 të Ushtruesit të Detyrës së Drejtorit të Departamenti të Administratës së Përgjithshme në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të njëjtit është dashur që të ushtrojnë fillimisht ankesë të brendshme në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave pranë Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, e me tej në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.*

Ndërlidhur si më lart, Kolegji i Këshillit ju referua edhe Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përkatësisht nenit 16 paragrafit 4 me të cilin është përcaktuar se: *Para parashtrimt të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t'i ketë shterur procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit, andaj në kuptim të dispozitave ligjore si më lart dhe duke marrë parasysh se me asnjë provë nuk dëshmohet se ankuesit të kenë ushtruar paraprakisht ankesë të brendshme në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave, kështu që, nisur nga ky konstatim si dhe në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vlerësoj se ankesa me numër A.nr.788/2021 e datës 08.09.2021 është e papranueshme.*

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **shpallet jo kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesi si në pikën II të dispozitivit, sepse:

Bazuar në të gjitha provat e lëndës konkretisht në Kontratën e Punës për Kohët të Pacaktuar të datës 15.06.2017, Kolegji, konstaton se ankuesi është i punësuar në pozitë Vozitës, rrjedhimisht meqenëse për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, aplikohet Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, atëherë sipas Kolegjit, pozita "Vozitës" nuk hyn në kuadër të pozitave të shërbimit civil, pasi që këto pozita konsiderohen si staf mbështetës dhe teknik ashtu siç është përcaktuar në bazë të nenit 4 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"Personelit i punësuar nga institucione e administratës në nivel qendror dhe komuna, përgjegjës për kryerjen e funksioneve mbështetëse dhe të mirëmbajtjes, nuk janë nëpunës civil"*, kjo është paraparë edhe me Qarkoren Administrative Nr. 01/2014 të Ministrisë së Administratës Publike ku është paraparë që pozita "Vozitës" hyn në kategorinë e funksioneve mbështetëse dhe të mirëmbajtjes, rrjedhimisht marrëdhënia e tyre e punës rregullohet me Ligjin e punës, ligje të veçanta, me marrëveshje kolektive ose më rregullore sektoriale ashtu siç është përcaktuar edhe në kontratën e ankuesit.

Nisur nga këto Kolegji, konstaton se me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar funksioni i ankesave në bazë të të cilit përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civilë, kështu që pasi pozita të cilin e mban ankuesi nuk është pozitë e shërbimit civil, atëherë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesi, andaj lidhur me pretendimet e tij, njëjti mund të vazhdoj procedurat konformë Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit si dhe në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative

brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.788/2021, datë 14/12/2022.

Avdyl Bekteshi

[Signature]
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankuesve, [REDACTED]
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.